



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:274254

Datë: 29.11.2024

Numri i dokumentit: 06525020

AC-I-24-0566

Në ankesën e

Paditësi/ankuesi

Q H nga Prizreni, të cilin e përfaqëson avokati H S nga Prizereni.

Kundër

E paditura

NSH, "UNIMONT" Prizren (në likuidim), të cilën e përfaqëson, **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakërishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-III -12-1526 të datës 9 korrik 2024, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 29 nëntor 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-III-12-1526 të datës 9 korrik 2024.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 24 shtator 1991, paditësi e ka dorzuar në Gjykatën Themelore të Punës së Bashkuar në Gjakovë propozim ndaj të paditurës për shkak të anulimit të vendimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Paditësi ka pohuar se ka qenë në marrëdhënie të punës për kohë të pa caktuar. E paditura ja ka ndërprerë marrëdhënien e punës me masën e shqiptuar disiplinore për shkak të lëshimit të detyrave të punës respektivisht për shkak të mungesës nga puna. Tutje ai pohon se vendimet për ndërprerje të marrëdhënies së punës janë kundër kushtetuese dhe kundërligjore, dhe se duhet të anulohet dhe të kthehet në vendin e tij të punës. Padisë ia ka bashkangjitur këto prova: Deklaratën, Vendimin për masë disiplinore për shkak të shkeljes së detyrimit të punës të disiplinës nr.228 dt.28 gusht 1991, Vendimin me të cilin hidhet poshtë kundërshtimi si i pabazuar ndaj vendimit nr.394 i datë 19 shtator 1991, regjistri i NSh-së me nr.572 datë 13 nëntor 1991, Aktvendimi nr.294 datë 21gusht 1991.

Pas shuarjes së Gjykatave Themelore të Punës së Bashkuar, dosja e lëndës dorezohet në Gjykatën Komunale në Prizeren, dhe merr numrin P1.468/92.

Me datë 23 shkurt 1993, Gjykata Komunale në Prizeren me Aktgjykimin P1.468/92 e aprovon kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, e anulon vendimin e ankimuar të paditësit për largim nga puna, dhe vendosë ta kthen paditësin në vendin e punës në NSH.

Me datë 28 prill 1993, e paditura e dorëzon në Gjykatën komunale në Prizren një ankesë ndaj Aktgjykimit të kësaj gjykate P1.468/92 të dates 23 shkurt 1993, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon që të anulohet Aktgjykimi i ankimuar dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Me datë 4 qershor 1993, Gjykata e Qarkut në Prizeren me Aktvendimin Gzh.br.309/93 e prishë Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizeren P1.br.468/92 të dates 23 shkurt 1993, dhe lëndën e kthen në rigjykim.

Me datë 27 gusht 2012, Gjykata Komunale në Prizren, me Aktvendimin e saj C.nr.490/93, është shpallur inkomptente në pikëpamje lëndore dhe lëndën ia ka dërguar në DHPGJS. Lënda në DHPGJS pastaj regjistrohet me numrin C-III-12-1526.

Me datë 25 shtator 2023 e paditura -AKP-ja ka parashtruar përgjigjen e saj , në të cilën pohoi se AKP e kundërshton në tërësi kërkesën e propozuesit pasi që nuk mund të verifikohet asnjë fakt me rëndësi. Nga provat e prezantuara nuk argumentohet asnjë fakt i rëndësishëm, ashtu që nuk mund të vërtetohet se paditësi me paditësen kanë pas raporte kontraktuese, ashtu që ta ketë dëmtuar apo privuar në punësim. Meqenëse ndërmarrja nuk është funksionale që një kohë të gjatë dhe është në likuidim, në këtë rast paditësi nuk ka ndonjë bazë të vlefshme juridike në të cilën mbështetet kërkesën e tij. Andaj ka propozuar që kërkesa e tij të refuzohet si e pa bazuar.

Me datë 20 qershor 2024, paditësi e ka dorezuar një parashtresë në DHPGJS dhe përgjigjet në mbrojtjen në padi të AKP-së. Ku ka pohuar se propozimi është ligjërish i bazuar, duke theksuar se e kundërpaditësja ia ka ndërprerë marrëdhënien e punës paditësit me datë 28 gusht 1991, pa zbatuar procedurë disiplinore dhe i njëjti në atë kohë e ka kundërshtuar vendimin. Në Gjykatën thgemelore të Punës së Bashkuar në Gjakovë, ndersa më vonë Gjykata komunale në Prizren e ka aprovuar kërkesëpadinë duke konstatuar se vendimi për largim nga puna ishte i kunderligjshem. Tutje ai pohon se Gjykata e Qarkut e ka prishë këtë Aktgjykim duke e kthyer lëndën në rigjëkim për shkaqe formale, për shkak të lëshimeve të gjykatës dhe jo për shkaqe material.

Me datë 9 korrik 2024, Shkalla e I-rë e DHPGJS me Aktgjykimin, C-III-12-1526 e refuzon kërkesëpadinë e paditësit sit ë pabazuar. Shkalla e I-rë e ka arsyetuar se, nuk është kontestues fakti se propozuesi ka qenë punëtor i NSH-së, por nga shkresat e lëndës gjykata vie në përfundim se i njëjti nuk ka ofruar ndonjë dëshmi

relevante që dëshmojnë se i takon e drejta për tu kthyer në vendin e punës. Pra ka dështuar që të dorëzojnë prova relevante në mbështetje të propozimit të tij edhe pas dërgimit të përgjigjes së kundërpropozueses për kundër përgjigje. Nga kjo gjykata vjen në përfundim që parashtruesi i propozimit nuk i ka përmbushur kriteret themelore të padisë. Parashtruesi do të mund të dorëzonte prova relevante në mbështetje të pretendimeve të tij, për të dëshmuar se mund të kthehet në vendin e punës, se vendimi për largim nga puna ka qenë i kundërligjshëm dhe mbi të gjitha se ekzistojnë kushtet ligjore për kthim në vendin e punës. Gjykata gjen se, në mungesë të dëshmive, pretendimet e paditësit lidhur me të drejtën e tij në anulim të vendimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, nuk janë të mbështetura në provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara. Edhe sikur të ekzistonte mundësia juridike që parashtruesi të kthehet në vendin e punës, kjo tashmë është bërë e pa mundur pasi që e paditura gjenden në fazën e likuidimit dhe aprovimi i propozimit nuk do të kishte asnjë efekt juridik, dhe meqenëse as pas paraqitjes së përgjigjes në mbrojtjen e AKP-së nuk e ka bërë zgjerimin e kërkesës apo për të paraqitur ndonjë kërkesë tjetër, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me datë 23 korrik 2024, përmes postës paditësi e ka dërguar në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-III-12-1526 të datës 9 korrik 2024, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar dhe të aprovohet kërkesëpadia e paditësit si e bazuar, ose të prishet Aktgjykimi i ankimuar dhe lënda të kthehet në rigjykim. Për më tepër paditësi në ankesë ka pohuar se me Aktgjykimin e ankimuar është shkelur neni 182.2. n) të LPK, pasi që ky Aktgjykim ka të meta, është i pa kuptueshëm në pikpamje të bazës ligjore për refuzimin e propozimit dhe është në kundërshtim me provat e arsyetuara në Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren. Tutje paditësi pohon se provat janë complete ndërsa gjykata nuk i përmend atë dhe se pa bazë thekson se nuk ka prova për pretendimet e padisë. Tutje ai pohon se është e habitshme se si Gjykata e Shkallës së I-rë i injoron provat në shkresat e lëndës. Tutje paditësi pohon se Shkalla e I-rë e DHPGJS ka vërtetuar gabim gjendjen faktike, duke pohuar se gjendja faktike është përmbledhur në propozimin e datës 23 shtator 1991 të dorëzuar në Gjykatën Themelore të Punës së Bashkuar në Gjakovë. Paditësi pretendon se Shkalla e I-rë e DHPGJS është dashur ta rigjykoj çështjen e jo të konstatoj se ska prova ta refuzoj padinë. Paditësi në ankesë

pretendon se i është nderprerë mardhenia e punës me datë 28 gusht 1991 nga masat e dhunshme të pushtetit okupues serb. Tutje ai paraqet në ankesë gjitha zhvillimet procedurale që kanë ndodhë lidhur me kërkesëpadinë e tij.

Me datën 27 gusht 2024, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS përgjigjen në ankesën e paditësit. Në përgjigje në ankesë AKP-ja i konteston pretendimet ankimore të paditësit dhe e mbështetë në tërësi Aktgjykimin e ankimuar të Shkallës së I-rë të DHPGJS. Në këtë parashtresë AKP-ja i është referuar zhvillimeve procedural që kanë ndodhë lidhur me kërkesëpadinë e paditësit. AKP-ja pohon se pas qershorit të vitit 1993 e deri në mars 1999 paditësi për këtë periudhë nuk ka prezentuar asnjë arsye për mos vazhdimin e këtij kontesti, ndersa barrën e të provuarit e ka paditësi. Kjo heshtje e paditësit të bën me dyshuar në akordimin e asaj që shkruan në deklaratën për masën disiplinore. Tutje AKP-ja pohon se përpjekjet për të sqaruar dispozitat diskriminuese të asaj kohe në ankesë janë të kota në raport me punëtorët shqipëtarë në periudhën e okupimit të Kosovës nga Serbia. Kjo ngase një shkelje e tillë e detyrës në punë nuk do të tolerohej në asnjë menyrë. Kur kësaj çështje i shtohet fakti se me rastin e hyrjes në likuidim të NSH-së, të gjithë punëtorët që u është nderprerë mardhënia e punës është dashur ti drejtohen Autoritetit të Likuidimit. Nga këto arsye, AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa e paditësit si e pa bazuar.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me padinë e tij, të cilën e quan Propozim të dorëzuar në Gjykatën Themelore të Punës së Bashkuar në Gjakovë me datë 24 shtator 1991 ka kërkuar që të konstatohet nga gjykata se vendimi i NSH-së nr.228

i datës 28 gusht 1991, dhe vendimi nr. 394 i datës 13 shtator 1991, janë vendime të kundërligjshme, dhe ai ka kërkuar që të kthehet në punë në vendin e tij të punës në NSH "UNIMONT" në Prizren. Në këtë padi ai ka pretenduar se vendimi për largimin e tij nga puna, ishte vendim jo ligjor madje edhe kundër kushtetues, duke pretenduar se nuk ka kryer shkelje disiplinore, për tu larguar ai nga puna.

Pas shumë zhvillimeve procedurale që kanë ndodhë lidhur me kërkesëpadinë e paditësit në gjykatat e rregullta, lënda ka përfunduar në DHPGJS, bazuar në Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prizren, C.nr 410/93 të datës 27 gusht 2012, me të cilin Aktvendim kjo gjykatë ka shpallë jo kompetencën lëndore për të vendosur lidhur me këtë padi.

AKP-ja me mbrojtje në padi të dorëzuar në DHPGJS me datë 25 shtator 2023, i ka kundërshtuar pretendimet e paditësit të cekura në padi se largimi nga puna ishte i kundërligjshëm. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet kërkesëpadia e paditësit si e pa bazuar.

Kolegji i Apelit vëren se AKP-ja me përgjigje në ankesë të dorëzuar në Shkallën e II-të të dorëzuar me datë 27 gusht 2024, ajo ka pohuar faktin se NSH "UNIMONT" në Prizren tashmë është në likuidim, ndërsa paditësi fare nuk i është drejtuar Autoritetit të Likuidimit lidhur me kërkesëpadinë e tij për kthim në punë.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën e tij në Shkallën e II-të ka pretenduar se që nga fillimi në vitin 1991, ai ka dorëzuar prova të mjaftuara me të cilat vërtetohet se vendimet e NSH-së ishin të kundërligjshme, dhe se është larguar nga puna në mënyrë të kundërligjshme.

Paditësi në fakt me padinë e tij të datës 24 shtator 1991, ai ka dorëzuar vendimet për largimin e tij nga puna, një Deklaratë dhe një Procesverbal. Provat e administruara dhe të arsyetuara në Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren P1468/92 datë 23 shkurt 1993, nuk mund të jetë objekt vlerësimi edhe nga kjo gjykatë, nga se ky Aktgjykim nuk është objekt i kësaj ankese. Andaj këto prova nuk janë bazë e mjaftuar që të aprovohet kërkesë padia e tij, kjo për faktin ky Aktgjykim në bazë të ankesës së të paditurës, ishte prishur me Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren G.zh.br.309/93 datë 4 qershor 1993, dhe lënda ishte kthyer në rigjykim.

Prandaj nuk ka bazë ligjore të konstatohet se në mënyrë të drejtë është vërtetuar gjendja faktike nga ana e Gjykatës Komunale në Prizren, dhe se janë mbështetur pretendimet për largimin e kundërligjshëm të paditësit nga puna.

Duke e ditur faktin që nuk është kontestues në mes palëve, se NSH "UNIMONT" në Prizren, tashmë është nën likuidim, konstatimi nga ana e gjykatës se vendimet e NSH-së për largimin e paditësit nga puna janë të kundërligjshme, nuk paraqitet si diçka e dobishme apo në interes të paditësit. Kjo për faktin se sikur paditësi edhe të kishte një vendim gjyqësor të formës së prerë që vërteton largimin e kundërligjshëm të tij nga puna, ai nuk do të mund të kërkonte kompensimin e pagave, pasi që ai ka dështuar të paraqitet me kohë dhe në suaza të afateve ligjore me kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit në procedurën e likuidimit.

Edhe kërkesa e paditësit për kthimin e tij në vendin e punës në NSH, nuk është më ligjërish e mundshme, pasi që NSH-ja është në likuidim, dhe këtë gjë në mënyrë të drejtë e ka konstatuar edhe shkalla e I-rë në Aktgjykimin e ankimuar.

Prandaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit i mbështetë të gjeturat faktike të Shkallës së I-rë të DHPGJS, ndërsa nuk i konsideron si të bazuara pretendimet ankimore të paditësit për shkelje të dispozitave procedurale, pretendimet për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, si dhe pretendimet për zbatim të gabuar të dispozitave materiale.

Nga këto arsye ankesa se paditësit refuzohet si e pa bazuar, dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Pasi që objekti i kërkesëpadisë nuk është i natyrës monetare, gjatë tërë procedurës gjyqësore asnjëra gjykatë e rregullt e cila është marrë me kërkesëpadinë e paditësit, nuk ka kërkuar nga paditësi pagesë të taksës gjyqësore, prandaj për një arsye të tillë nuk caktohen taksa gjyqësore as për procedurën ankimore.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së me datë 29 nëntor 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues _____